

DRUŠTVO SA OGRANIČENOM ODGOVORNOSTJU  
"VODOVOD I KANALIZACIJA TUZI"

Broj 3839/22

Tuzi, 09.12. 2022 god.



VODOVOD I KANALIZACIJA  
UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI  
D.O.O. TUZI / SH.P.K TUZ

**OPŠTINA TUZI/KOMUNA E TUZIT**

**PROGRAMI I PUNËS ME PLAN FINANCIAR  
PËR VITIN 2023  
SHPK "VODOVOD I KANALIZACIJA/UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI" TUZ**

**DREJTORI EKZEKUTIV**  
Admir Biorac dipl.ecc

**Tuz, dhjetor 2022**

## **PËRMBAJTJA**

<b>I HYRJE.....</b>	<b>4</b>
1.1. Të dhënat themelore të Shoqërisë.....	5
1.2. Politika e menaxhimit/Misioni, vizioni dhe strategjia e Shoqërisë.....	6
1.3. Vështrim i dispozitave themelore me të cilat rregullohet veprimitaria e kompanisë.....	6
1.4. Veprimitaria themelore dhe qëllimet e shoqërisë.....	8
1.5. Ekipi menaxhues dhe organizimi i Shoqërisë.....	8
1.6. Aspektet administrativo teknike të Shoqërisë.....	9
1.7. Analiza e gjendjes aktuale.....	9
1.8. Bashkëpunimi me organet, shërbimet publike dhe organizatat tjera, që është me ndikim në realizimin e Programit.....	10
1.9. Skema organizative e Shoqërisë.....	11
1.10. Numri dhe struktura e të punësuarve.....	11
1.11. Pagat mesatare.....	12
1.12. Struktura sipas moshës.....	12
<b>II STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMPANISË.....</b>	<b>12</b>
2.1. Pajisja teknike.....	13
2.2. Aktivitetet programore.....	13
2.3. Aktivitetet prioritare(sektori teknik).....	14
2.4. Sektori për punët ekonomiko juridike.....	16
2.5. Aktivitetet prioritare të sektorit (shërbimi për çështjet juridike).....	17
<b>III VEPRIMITARIA THEMELORE E SHOQËRISË.....</b>	<b>21</b>
3.1. Sistemi për furnizim me ujë.....	21
3.2. Rrjeti i ujësjellësit.....	21
3.3. Stacionet e pompimit.....	21
3.4. Kualiteti i ujit.....	22
3.5. Politika e çmimeve.....	22
3.6. Menaxhimi i risqeve.....	23
3.7. Veprimitaria shtesë e Shoqërisë.....	23
3.8. Aktivitetet e planifikuara në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në vitin 2023.....	24
3.9. Kompletimi i kadastrës së instalimeve për rrjetin e ujësjellësit Tuz.....	25
3.10. Sistemi i kanalizimit atmosferik.....	26
3.11. Programi i aktiviteteve në bazë të kontratave të planifikuara me vetëqeverisjen lokale....	26
<b>IV PLANI FINANCIAR .....</b>	<b>26</b>
<b>V PLANI I PROKURIMEVE PUBLIKE.....</b>	<b>30</b>
5.1. Mjetet e planifikuara financiare për prokurimin e të mirave, punimeve dhe shërbimeve....	31
5.2. Politika e pagave dhe punësimeve.....	32

5.3. Plani i raportimit.....	33
5.4. Përfundim.....	33

### **Listat e tabelave**

- Tabela 1 - Skema organizative e Shoqërisë;
- Tabela 2 - Struktura e kualifikimeve të të punësuarve
- Tabela 3 - Paga mesatare e të punësuarve
- Tabela 4 - Struktura sipas moshës e të punësuarve
- Tabela 5 - Pajisja teknike e Shoqërisë
- Tabela 6 - Prioritetet e planifikuara të sektorit teknik
- Tabela 7 - Prioritetet e planifikuara të sektorit për punët ekonomiko juridike
- Tabela 8 - Menaxhimi me risqet e Shoqërisë
- Tabela 9 - Plani i aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve shtesë në vitin 2023
- Tabela 10 – Aktivitetet e planifikuara për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit
- Tabela 11 - Pasqyrim analistik i të ardhurave të Shoqërisë për vitin 2023
- Tabela 12 – Pasqyrim analistik i shpenzimeve të Shoqërisë për vitin 2023
- Tabela 13 – Plani financiar dhe vështrimi përmbledhës
- Tabela 14- Prokurimi publik i mallrave
- Tabela 15 – Prokurimi publik i shërbimeve
- Tabela 16- Prokurimi publik i punimeve

Në bazë të Nenit 26 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale ("Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 055/16, 074/16, 066/19), Nenit 28 paragrafi 7 të Statutit të SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, në propozim të Drejtorit ekzekutiv, Bordi i drejtoreve në seancë të rregulltë, më 06.12.2022 aprovon:

**PROGRAMIN E PUNËS TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "VODOVOD I  
KANALIZACIJA/UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI" TUZ  
PËR VITIN 2023**

**1. HYRJE**

Me programin e punës përcaktohen punët të cilat SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, i planifikon në vitin 2023. Punët e prezantuara me këtë program kanë bazën në Ligjin mbi veprimtaritë komunale („Gz. zyrtare e MZ“ nr. 55/16, 074/16 i 002/18“), dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës së Tuzit mbi furnizimin publik me ujë nr.02-030/21-14526 i dt. 24.11.2021 („Gz. zyrtare e MZ – dispozitat komunale“ nr.046/21).

Aspektet e përgjithshme dhe koha në të cilën përpilohet Plani i punës për vitin 2023 janë shumë komplekse dhe të paparashikueshme, në kushtet e shpejtësisë së ndryshimeve dhe lëvizjeve në tregun e mallrave, punimeve dhe shërbimeve, me ç'gjë është i kushtëzuar edhe përpilimi i mikro dhe makro planeve në periudhë më të shkurtër apo më të gjatë kohore.

Qëllimi i përpilimit të Planit është që në mënyrë sistemore të përcaktohen aktivitetet për vitin e ardhshëm dhe ato aktivitete t'u jepen personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve të planifikuara në kornizën e definuar kohore.

Esenca e të planifikuarit strategjik është në dallimin e rasteve të pritura dhe kërcënimeve nga mjedisë i jashtëm, të cilat mund të ndodhin në të ardhmen dhe të cilat vendosen në marrëdhënie me fuqitë dhe dobësitë e mjedisit, e të cilat gjatë periudhës së planifikuar duhet të zhvillohen që të mund të shfrytëzohen rastet e të evitohen kërcënimet, si dhe dobësitë e veta. Ky është proces që paraqet udhërrëfyes për ndryshime, e i cili duhet të prodhojë rezultate të dëshiruara financiare si pasojë e atyre ndryshimeve.

Në periudhën e ardhshme të planifikuar Shoqëria do të vazhdojë të punojë në mirëmbajtjen vijuese të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe si qëllim kryesor do të ketë furnizimin e rregullt të banorëve me ujë të pijshëm në trevën e komunës së Tuzit. Në lëminë e mirëmbajtjes investuese të sistemit të furnizimit me ujë, planifikohet metoda e kombinuar, gjegjësisht që kryerjen e punëve të vëllimit më të vogël t'ua besojmë të punësuarve në Shoqëri, derisa për punët të cilat Shoqëria nuk mund t'i kryejë vetëm për shkak të vëllimit ose kompleksitetit të punës planifikohet angazhimi i kompanive tjera.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara të përkruara, supozimi është që të shfrytëzohen maksimalisht të gjitha resurset ekzistuese, si dhe rritja e efikasitetit të punës të punësuarve përmes organizimit të punës në kompani dhe me përgjegjësi ndaj obligimeve të marra.

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara është përgatitur dhe është aprovuar Rregullorja dhe programi i masave nga fusha e mbrojtjes në punë (MNP), kurse kryerja e detyrave është planifikuar me dinamikë mujore.

Në kuadër të masave stabilizuese të cilat ka për qëllim t'i zbatojë Drejtoria e Shoqërisë gjatë periudhës planifikuese është inkuadrimi i kontrollit në prokurimet publike, si dhe përcjellja institucionale e realizimit të Kontratave të lidhura përmes zgjidhjeve aplikative të sistemit afaristo-informatik dhe me përgatitjen e Rregullores së re mbi punën, ku pjesë përbërëse është edhe sistematizimi dhe organizimi i brendshëm i Shoqërisë. Ky Program i punës është i përgatitur në pajtim me metodologjinë përkatëse të planifikimit, e në bazë të dhënavë të mbledhura nga të gjitha pjesët organizative të Shoqërisë.

**1.1 TË DHËNAT THEMELORE STATUSORE TË SHOQËRISË**

**Emërtimi zyrtarështë:**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz;  
**Forma e shkurtë e emërtimit të kompanisë:**

SHPK"Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz;

**Statusi juridik**

Aktiv

**Forma e organizimit:**

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;

**Themelues**

Kuvendi i Komunës së Tuzit;

**Selia:**

Tuz, rruga 12 numër 48;

**Veprimtaria kryesore:**

36.00 Grumbullimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit;

37.00 Menaxhimi i ujërave të zeza;

**Numri amëz**

33/31-00169-3

**NIT:**

03399702

**Llogaria për transaksione**

520-44497-56

**Organi mbikqyrës i vetëqeverisjes lokale:**

Sekretariati për punë ekonomike

**Bordi i drejtoreve:**

Anëtarët e Bordit të drejtoreve janë emëruar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Tuzit, numër: 02-030/21-14526, më 24.11.2021 ("Gazeta zyrtare e Malit të Zi-dispozitat komunale" numër 040/21 e dt. 03.12.2021). Anëtarët e Bordit të drejtoreve janë emëruar për periudhën e mandatit katër vjeçar, duke filluar prej më 24 nëntor 2021.

1. Fran Camaj, kryetar
2. Almira Sabotic, anëtar
3. Tonino Juncaj, anëtar
4. Prelja Plumaj, anëtar
5. Admir Nikaj, anëtar

**Drejtor:**

Admir Biorac dipl.ecc

Drejtori i shoqërisë është emëruar më 09.09.2022 – në seancën e 14-të të Kuvendit të Komunës së Tuzit.

**Të dhënat mbi regjistrimin e parë:**

Nr.5-1000519/002, më 23.09.2021

**Adresa elektronike:** vodovod-ujesjellesi.tuz@hotmail.com

**Web faqja**

**Telefoni:** 020/325-013

**1.2. POLITIKA E MENAXHIMIT - MISIONI, VIZIONI DHE STRATEGJIA E SHOQËRISË**

## **Misioni**

Me njoħuritē dhe veprimitarini e vetē SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, ka obligim t'u siguroj tē gjithë konsumatorëve, furnizim publik tē sigurtē dhe cilësor me ujë dhe kullim tē ujërave tē zeza me qëllimin e pérhershém tē ruajtjes së ambientit dhe shëndetit tē konsumatorit. Jemi tē orientuar në rritjen e besueshmërisë nē ofrīmin e shërbimeve tona, zgjerimin e rrjetit tē ujësjellësit dhe kanalizimit dhe përmes kësaj tē orientuar në dhënien e kontributit pér përmirësimin e kushteve tē jetesës së qytetarëve, si dhe fleksibilitetin dhe transparencën nē komunikim me tē tjerët, para së gjithash me shfrytëzuesit e shërbimeve tē furnizimit me ujë dhe kullimit.

## **Vizioni**

SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, eshtë kompani e suksesshme nē lëminë e furnizimit me ujë dhe kullimit tē ujërave tē zeza dhe menaxhmenti e gjithë tē punësuarit përpiken që kështu tē mbesë edhe nē periudhën vijuese. Sistematikisht dhe me plan jetësohet zhvillimi stabil i kompanisë me implementimin e pérhershém tē ideve tē reja dhe inovacioneve teknike. Nga momenti i themelimit, aftësia e organizatës eshtë që vazhdimisht tē prodhojë dhe furnizoje konsumatorët me ujë cilësor dhe tē rregullt nga ana higienike, e ai do tē ishte vizioni i qartë që eshtë edhe deri më sot imperative i veprimitarisë së menaxhmentit tē Shoqërisë SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz.

### **Strategja**

Në mënyrë që misioni i kompanisë tē plotësohet dhe vizonet e zhvillimit tē kompanisë tē realizohen, eshtë definuar edhe strategja e cila konsiston nē këtë si vijon:

- Kontinuitetin e shërbimit cilësor nē procesin e prodhimit dhe shpërndarjes tē ujit tē pijshém tē rregullt nga ana higienike dhe kullimit tē ujit nga reshjet e shiut;
- Menaxhimin racional dhe optimal me tē gjitha funktionet e biznesit tē Shoqërisë me qëllim tē rritjes dhe zhvillimit fitimprurës;
- Veprimitari e pavarur financiare e kompanisë nē mënyrë tē qëndrueshme dhe sipas parimeve tē tregut;
- Përcjellja, investimi dhe implementimi i teknologjive dhe njoħurive bashkëkohore nē lëminë e furnizimit me ujë dhe kullimit tē ujërave tē zeza;
- Mirëmbajtja parandaluese, vijuese dhe investuese e sistemit ekzistues tē ujësjellësit dhe kanalizimit dhe objekteve përcjellëse infrastrukturore, instalimeve dhe pajisjeve;
- Respektimi i obligimeve tē definuara me dokumentat strategjike tē nivelit më tē lartë tē Menaxhimit;
- Shfrytëzimi i tē gjitha mundësive tē hapura tē cilat nuk janë tē definuara veçanërisht me ligje, e tē cilat i mundësojnë kompanisë ta shfrytëzojë nē maksimum autonominë e vetë nē planifikim dhe menaxhim tē zhvillimit tē shërbimeve komunale;

## **1.3. Vështrim i dispozitave themelore me tē cilat rregullohet veprimitaria e kompanisë**

Korniza legjislativë nē bazë tē cilës SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz vepron, bazohet nē parimet dhe kushtet e pérmbajtura nē ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet si vijon:

**Ligji mbi veprimitaritë komunale** („Gz. zyrtare e MZ“, nr. 55/16, 074/16 i 002/18)

**Ligji mbi vetëqeverisjen lokale** („Gz. zyrtare e MZ“, nr. 2/2018, 34/2019 i 38/2020)

**Ligji mbi shoqëritë tregtare** („Gz. zyrtare e MZ“, nr. 65/2020)

**Ligji mbi metrologjinë** („Gz. zyrtare e MZ“, nr. 79/08 i 40/11)

**Ligji mbi mbrojtjen e personave dhe pronës** („Gz. zyrtare e MZ“, nr. 43/18)

**Ligji mbi punën** („Gazeta zyrtare e Malit tē Zi“, numér 32/13, 75/14, 75,13/17, 113/17, 95/18)

**Ligji mbi ndërmarrjet publike** („Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi”, numër 6/91)  
**Ligji mbi ujërat** („Gz. zyrtare e MZ”, nr.027/10, 073/10, 032/11, 047/11, 048/15, , 055/16, 002/17, 080/17 i 084/18)  
**Ligji mbi prokurimet publike** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 074/19)  
**Ligji mbi sigurimet e pensionit dhe invaliditetit** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 010/15,044/15,042/16,055/16,080/20);  
**Ligji mbi kontabilitetin** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 66/19 i 145/21)  
**Ligji mbi tatinin në vlerën e shtuar** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 053/16,001/17,050/17,046/19,073/19,080/20,008/21,59/21);  
**Ligji mbi sigurimin e ujit të pijshëm të rregullt nga ana shëndetësore për konsumim njerëzor** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 80/17)  
**Ligji mbi planifikim dhe ndërtim** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 064/17,044/18,063/18,011/19,082/20)  
**Ligji mbi pronën shtetërore** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 21/09,40/11);  
**Ligji mbi mbetjet komunale** („Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, numër 064/11,039/16);  
Shoqëria implementon edhe dispozitat tjera nga lëmia e kontabilitetit (Standardeve ndërkombëtare-MPS, të drejtave nga marrëdhënia e punës, akteve interne dhe rregulloreve në Shoqëri, si dhe udhëzimeve dhe instrukSIONEVE të themeluesit, prej akteve interne më të rëndësishmet janë:  
**Statuti i SHPK “Vodovoda i kanalizacija/ Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz numër 15/21 i dt. 01.12.2021**  
**Rregullorja e organizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës nr. 02/21 i dt. 21.12.2021**  
**Rregullorja mbi kontabilitetin dhe politikat kontabiliste.**

#### **Kontrata kolektive**

**Vendimi mbi themelimin e SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz**  
**Rregullorja mbi mënyrën, kushtet dhe afatet e regjistrimit të pronës dhe obligimi i harmonizimit të gjendjes sipas librave të biznesit me gjendjen sipas regjistrimit të SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz**

**Vendimi mbi furnizim me ujë në trevën e Komunës së Tuzit** („Gz. zyrtare e MZ – dispozitat komunale”, nr.046/21)

**Rregullave mbi minimumin e kualitetit dhe vëllimin e punëve për kryerjen e veprimitarive të rregulluara komunale** („Gz. zyrtare e MZ”, nr. 058/19 od 18.10.2019)

Shoqëria implementon edhe dispozitat tjera nga lëmia: e kontabilitetit (standardet MRS), marrëdhënieve të punës, akteve interne dhe rregulloreve në Shoqëri.

Shoqëria është themeluar si njëanëtarëshe, kurse themeluesi i Shoqërisë është Kuvendi i Komunës së Tuzit. Kapitalin themelor të Shoqërisë e përbën kapitali themelor i **T h e m e l u e s i t** dhe SHPK „Vodovod i kanalizacija/ Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz, përkatësisht prona e Shoqërisë, sendet e luajtshme dhe mjetet monetare.

#### **1.4. Veprimitaritë themelore dhe qëllimet e shoqërisë në vitin 2023**

SHPK „ Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz, është themeluar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Tuzit numër 02-030/21-14526 të dt. 24.11.2021 („Gz. zyrtare e MZ – dispozitat komunale”, nr.040/21 të dt. 03.12.2021).

Veprimitaria e Shoqërisë është e definuar me aktin themelues dhe me Statut dhe ajo kryen veprimitaritë vijuese komunale të rëndësise publike që janë:

- Furnizimi publik me ujë

- Menaxhimi me ujërat atmosferike

Veprimitaritë nga paragrafi paraprak janë veprimtari të interesit publik.

Shoqëria mund të kryejë veprimtari shtesë:

- Ndërtim të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit
- Mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit

Burime të financimit për shërbimet e interesit publik janë:

- Çmimi i shërbimit komunal përkatësisht prodhimit komunal
- Buxheti i vetëqeverisjes lokale
- Burimet tjera në pajtim me ligjin

## **1.5. Ekipi menaxhues dhe organizimi i Shoqërisë**

Bordi i drejtorëve i Shoqërisë është emëruar në seancën e Kuvendit të Komunës së Tuzit, të mbajtur më 24 nëntor 2021, me mandat 4 vjeçar.

Organet e Shoqërisë janë:

- **Bordi i drejtorëve** (si organ i menaxhimit), i cili përcakton politikën afariste, sjellë akte të përgjithshme, aprovon programe dhe raporte, përcakton çmimoren e shërbimeve dhe kryen punët tjera të përcaktuara me dispozitat përkatëse. Ky organ numëron 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve 4 (katër) janë përfaqësuesit e Themeluesit, e 1 (një) është përfaqësuesi i të punësuarve në Shoqëri.
- **Drejtori ekzekutiv i Shoqërisë** (si organ udhëheqës), që organizon dhe udhëheq veprimtarinë e Shoqërisë, përgjigjet për ligjshmérinë e punës së Shoqërisë, implementon vendimet e Bordit të drejtorëve dhe vendos mbi çështjet tjera të lidhura me punën dhe veprimtarinë vijuese të Shoqërisë. Drejtorin ekzekutiv e emëron Themeluesi në bazë të shpalljes publike; e procedurën e shpalljes publike, në emër të Themeluesit e zbaton Bordi i drejtorëve.

Pasi me aktet themeluëse të Shoqërisë është i normuar obligimi i vlerësimit të pronës së Shoqërisë, në periudhën vijuese pritet të kryhet evidentimi i pronës, në bashkëpunim me organet kompetente të Komunës së Tuzit, Administratën e patundshmërive dhe organet tjera, në mënyrë që të kryhet regjistrimi i saktë dhe i plotë i të njëjtës në bazë të pronësisë dhe në bazë të përdorimit. Në lidhje me këtë është e nevojshme të theksohet se me Propozimin e Ligjit mbi veprimitaritë komunale është parashikuar që infrastruktura komunale, që është e domosdoshme për kryerjen e veprimitarive komunale, është e mirë lokale në pronësi shtetërore me të cilën disponon njësia e vetëqeverisjes lokale, për të cilën duhet të regjistrojë të drejtat e pronësisë; e kryerësi i veprimitarisë komunale e përdor infrastrukturën komunale. Duke marrë parasysh këtë, prona e Shoqërisë që shërben për kryerjen e veprimitarisë të furnizimit publik me ujë (burimet me truall, stacionet e pompimit, rezervuaret dhe tubacionet), si dhe për kryerjen e veprimitarisë së kullimit dhe pastrimit të ujërave të zeza (rrjeti i kanalizimit, kolektorët dhe pajisja për pastrimin e ujërave të zeza), është infrastrukturë komunale dhe e njëjtë nuk mund të jetë në pronësi të Shoqërisë, por në pronësi shtetërore, përkatësisht komunale, e Shoqëria në të njëjtat mund të ketë të drejtën e menaxhimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes dhe si e tillë e regjistruar pranë organit kompetent.

## **1.6. Aspektet administrativo teknike të Shoqërisë**

Aspektet administrativo-teknike kanë të bëjnë me:

- Mbajtjen e seancës së Bordit të drejtorëve të Shoqërisë dhe çështjet juridike të punës.



- Për mbajtjen e seancave gjatë vitit 2023, planifikohen seancat e Bordit të drejtorëve, në pajtim me obligimet e përcaktuara me aktet themeluese dhe nevojat e procesit të punës të Shoqërisë.

Marrëdhëniet juridike të punës me të punësuarit përfshijnë:

- Zgjidhjen e çështjeve juridike të punës të punësuarve (kérkesat, iniciativat, pagat, kompensimet, udhëtimet zyrtare dhe ngjashëm) aktivitet i vazhdueshëm gjatë vitit 2023

## **1.7. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE**

Me rastin e përpilimit të Programit të punës për vitin 2023 është bërë analiza e gjendjes së Shoqërisë, gjegjësisht SWOT analiza. Me analizë janë identifikuar fuqitë dhe dobësítë e vetë sistemit të Shoqërisë dhe ambientit të saj të brendshëm, si dhe kërcënimet dhe mundësítë në ambientin e jashtëm, në të cilat Shoqëria në masën më të madhe nuk mund të ketë ndikim.

Anët pozitive të Shoqërisë tregtare:

- Subjekt tregtar i rëndësishëm në funksionimin e bashkësisë;
- Cilësia e ujit në burime i plotëson standarde;
- Shkallë e kënaqshme e lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit;
- Pajisje relativisht e mirë e Shoqërisë;
- Numër i konsiderueshëm i kuadrove profesional;
- Bashkëpunim i mirë me vetëqeverisjen lokale;

Kërcënimet për veprimtarinë e Shoqërisë:

- Mjete të pamjaftueshme financiare për investime më të konsiderueshme në infrastrukturë;
- Rritja e vazhdueshme e çmimeve të inputit (rryma, karburanti, materialet etj.);
- Tendenca e zvogëlimit të realizimit të faturuar;
- Mangësi të caktuara të Ligjit mbi veprimtaritë komunale;
- Vetëdije e pazhvilluar mbi rëndësinë e ujit dhe nevojën e ruajtjes së tij
- Fluktuationet e numrit të përdoruesve për shkak të kategorisë së konsumatorëve - sezonalët;
- Prioritete të çrregulluara të përdoruesve me rastin e pagesës së obligimeve.

Dobësítë evidente të Shoqërisë:

- Ndërtueshmëria e pamjaftueshme e sistemit të kanalizimit;
- Shkallë e konsiderueshme e ujit pa të ardhura;
- Lidhjet e paligjshme në sistemin e ujësjellësit;
- Procesi relativisht i gjatë i arkëtimit të detyrueshëm përmes përmbaruesve publik
- Mjete të pamjaftueshme financiare për investime më të konsiderueshme.

## **1.8. Bashkëpunimi me organet dhe shërbimet publike që janë me ndikim në realizimin e Programit**


Me qëllim të kryerjes efikase të detyrave programore dhe zhvillimore të kësaj Shoqërie, është e domosdoshme që në mënyrë strategjike të përmirësohet bashkëpunimi me të gjitha organet e vetëqeverisjes lokale dhe

organet tjera kompetente, siç janë:

- Sekretariati për zhvillimin ekonomik (organi i mbikqyrjes i kësaj Shoqërie),
- Agjencioni rregullues për energetikë (trupi rregullues për veprimtaritë e rregulluara komunale),
- Sekretariati për komunikacion,
- Drejtoria e policisë (asistenca e zyrtarëve policor me rastin e arkëtimit dhe zbatimit të masave ndaj konsumatorëve – debitorëve me qëllim të plotësimit të obligimeve të tyre, si dhe procedimit në bazë të kallëzimeve penale),
- Policia komunale (ofrimi i shërbimeve me kërkesë të Shoqërisë për ndërhyrje të caktuara ndaj konsumatorëve),
- Instituti për shëndetin publik (përcjellja dhe zbatimi i të gjitha masave të normuara mbi rregullsinë e ujit të pijshëm nga ana higjenike),
- Elektroekonomia e MZ, Posta e MZ dhe Telekomi i MZ (pagesa e një pjese të borxhit për energjinë elektrike për ujësjellësat rural; dorëzimi më efikas i llogarive konsumatorëve; bashkëpunimi përmes aktiviteteve të planifikuara të leximit të ujëmatësve nga distanca),
- Enti për metrologji (koordinimi i punës sa i përket çështjes së përgatitjes dhe kalibrimit).

## 1.9. Skema organizative e Shoqërisë

Tabela 1



## 1.10. Numri dhe struktura e të punësuarve

Sipas Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, në fuqi, të SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz janë të sistematizuara gjithsejt 35 vende të punës me 68 ekzekutues. Shoqëria për momentin punëson 39, e 22 prej tyre janë të punësuar në afat të pacaktuar, kurse 17 me afat të caktuar. Struktura sipas sektorëve është si vijon:

drejtori.....KPL - 1  
 nd. drejtori .....KPL - 1

#### **RESURSET NJERËZORE Tabela nr. 2 Struktura e kualifikimeve të punësuarve të Shoqërisë**

	SEKTORI/SHËRBIMI	EKIPI	Numri i të punësuarve	KPL	SHL	KPM	KU	GJK	PK
1	DREJTORIA	2							
2	SEKTORI TEKNIK		24	4	0	16	0	0	4
3	SEKTORI PËR PUNËT JURIDIKE DHE EKONOMIKE		13	5	0	7	0	0	1
	Gjithsejt		39	9	0	23	0	0	5

Domethënia e akronimeve për kualifikime: KPL – Kualifikim Profesional i Lartë, SHL- Shkollë e Lartë, KPM – Kualifikim Profesional i Mesëm, KU – I/e kualifikuar, GJK – Gjysëm i/e kualifikuar, PK – Pa kualifikim.

#### **1.11. Pagat mesatare**

Pagat mesatare me pjesën fillestare të ardhurave që përfshijnë kompensimet për regres për pushim vjetor dhe shpenzimet e ushqimit gjatë punës, e të cilat sipas dispozitave ligjore janë transferuar në pjesën fillestare të pagës, sipas kualifikimit profesional janë si vijon:

Tabela 3

Kualifikimi profesional	Paga mesatare neto
KPL	620.00 €
KPM	465.00€
KU	450.00€
PK	450.00€

Paga mesatare me pjesën fillestare që përfshinë kompensimin për regres për pushim vjetor dhe shpenzimet e ushqimit gjatë punës, e të cilat sipas dispozitave ligjore janë transferuar në pjesën fillestare të pagës është 510.00€. Numri i të punësuarve në Shoqëri është i mjaftueshëm për kryerjen e papenguar dhe cilësore të veprimtarisë, ç'gjë e tregon edhe indikatori i kualitetit të shërbimeve që është në nivelin e normuar nga standardet ndërkontinentale. Gjithashtu, në nivel të kënaqshëm është edhe struktura kualifikuese dhe sipas moshës, e kjo më së miri dëshmohet me faktin se numri i të punësuarve të cilët kryejnë punët nga lëmia e veprimtarisë themelore përbën 60,87% të numrit total.

#### **1.12. Struktura e të punësuarve sipas moshës**

Tabela 4

Numri rendor	Përkrahje	Numri i të punësuarve
1	Deri në 30 vjeç	11
2	30 deri 40 vjeç	17
3	40 deri 50	9
4	50 deri 60	0
5	Mbi 60	2
Gjithsejt		39

## **II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMPANISË**

Organizimi i Shoqërisë është i rregulluar me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz numër 02/21 e vitit 2021. Duke u bazuar në Rregulloren e SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, janë sistemuar 68 vende të punës, ku janë llogaritur edhe vendet e anëtarëve të Bordit të drejtoreve.

Për kryerjen e veprimtarisë ligjore SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, ka vendosur skemën adekuate organizative të cilën e përbëjnë, dy sektorë:

-Sektori teknik

-Sektori për punët ekonomike dhe juridike

Shoqëria për kryerjen e veprimtarive të veta ka konceptuar strukturën organizative funksionale që mundëson përdorimin efikas të gjitha resurseve të disponueshme dhe shfrytëzimin racional të njojurive dhe aftësive të punësuarve.

Për kryerjen e veprimtarisë në SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz janë organizuar sektorët si njësi themelore organizative. Secili sektor ka njësitë organizative në përbërjen e vetë dhe atë: shërbimet, departamentet. Në atë drejtim çdo njësi organizative i ka detyrimet e përcaktuara qartë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit Tuz.

Numri i të punësuarve në Shoqëri është i mjaftueshëm për kryerjen e papenguar dhe cilësore të veprimtarisë, ç'gjë e tregon edhe indikatori i kualitetit të shërbimeve që është në nivelin e normuar nga standartet ndërkombëtare. Gjithashtu, në nivel të kënaqshëm është edhe struktura kualifikuese dhe sipas moshës, e kjo më së miri dëshmohet me faktin se numri i të punësuarve të cilët kryejnë punët nga lëmia e veprimtarisë themelore përbën 60,87% të numrit total.

### **2.1. Pajisja teknike e Shoqërisë**

Shoqëria nuk disponon me Ndërtesë të Drejtorisë në Tuz. Në mënyrë që sistemi të funksionojë në tërësi, është e domosdoshme që në periudhën vijuese të punohet në ndërtimin, jo vetëm të Ndërtesës së Drejtorisë, por edhe të ndërtesës me përmbajtje administrativo-operative, ku do të vendoseshin dhoma e kalibrimit, laboratori për testimin e kualitetit të ujit të pijshëm, mirëmbajtja elektro-mekanike, punëtoria për mirëmbajtjen e automjeteve, hapësirë depoje, qendra për menaxhim nga distanca me sistemin e ujësjellësit – qendra dispeçer përmes të cilës do të kryhej optimizimi i shpenzimit dhe kontrolli i sistemit të ujësjellësit.

**Tabela 5:**

Nr.r	Automjete dhe mekanizim	Shoqëria disponon me
1	Llojet e automjeteve	
2	Automjet furgon	1
3	Automjet pasagjerësh	1

### **2.2. AKTIVITETET PROGRAMORE (SEKTORI TEKNIK) NË VITIN 2023**

Aktivitetet të cilat kanë prioritet absolut në pajtim me misionin e Kompanisë dhe obligimin e kryerjes të shërbimeve komunale konsistonë në dërgimin e sasive të mjaftueshme të ujit të rregullt nga ana higjenike, të



gjithë konsumatorëve të sistemit të ujësjellësit. Në pajtim me këtë, është e nevojshme që të gjitha pjesët e këtyre sistemeve të mbahen përherë në gjendje të rregullt pune dhe në funksion të plotë, ç'gjë është e mundshme të realizohet me sigurimin me kohë të sasisë së materialeve kualitative dhe rezervave të tyre, shërbimeve nga ana e disa furnizuesve, përgatitja dhe pajisja e të punësuarve, mobiliteti dhe organizimi i mirë i punës.

Me qëllim të avansimit të mëtejmë të sistemit të ujësjellësit është e domosdoshme të përcaktohen prioritetet vijuese:

### **2.3. AKTIVITETET PRIORITARE (SEKTORI TEKNIK) në vitin 2023**

**Tabela 6**

Nr.r	QËLLIMI OPERATIV	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA
1	<b>Mirëmbajtja efikase dhe e rregullt e rrjetit të ujësjellësit me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbulimi me kohë dhe zvogëlimi i humbjeve teknike dhe të ashtuquajturave humbje në rrjet;</li> <li>• Riparimi i të gjitha defekteve në rrjetin e ujësjellësit</li> <li>• Ndrrimi i disa akseve të rrjetit të ujësjellësit në kuadër të punimeve urgjente;</li> <li>• Inspektimi i rregullt i të gjitha nyjeve në pjesën e tubacioneve magjistrale, riparimi i tubacionit dhe ndrrimi i të gjitha mbyllëseve dhe valvulave të ajrit të dëmtuara;</li> <li>• Punimi i lidhjeve të reja në rrjetin e ujësjellësit dhe zhvendosja e atyre ekzistuese në bazë të kërkesave të pranuara të konsumatorëve;</li> <li>• Zhvendosja e ujëmatësve në bazë të kërkesave të pranuara të konsumatorëve;</li> <li>• Zbatimi i konsumimit të planifikuar të ujit në disa zona në rastin e zvogëlimit të prurjeve të burimeve gjatë periudhës së verës;</li> <li>• Mirëmbajtja e instalimeve të ujësjellësit në rubinetat publike në gjendje të rregullt pune.</li> </ul>

	<b>Mirëmbajtja e objekteve në rrjetin e ujësjellësit në gjendje funksionale dhe modernizimi i tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pastrimi i pusetave të ujësjellësit dhe ndrrimi i pjesëve të vjetër uara të armaturës dhe pjesëve tjera;</li> <li>• Inspektimi dhe riparimet e domosdoshme në të gjithë hidrantët aktiv në rrjetin e ujësjellësit;</li> <li>• Pastrimi i rregulltës dhe mirëmbajtja e rubinetave të qytetit në gjendje funksionale;</li> <li>• Riparimi i sipërfaqeve të betonit dhe të asfaltit të dëmtuara me rastin e kryerjes së punimeve në mirëmbajtjen e infrastrukturës hidroteknike.</li> </ul>
2		
3	<b>Përcjellja e kualitetit të ujit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrja dhe testimi i rregullt i ujit i vëllimit themelor (analiza A), 24 mostra katër herë në muaj;</li> <li>• Testimi periodik (analiza B) i kualitetit të ujit, 12 mostra dy herë në vit;</li> <li>• Testimi periodik (analiza C) i kualitetit të ujit, 6 mostra në vit;</li> <li>• Kontrolli i përditshëm i përqendrimit të klorit rezidual në burimet dhe disa vende të rrjedhjes në vendbanime;</li> <li>• Ekzaminimi i jashtëzakonshëm i ujit në rastet e reshjeve të dendura dhe paraqitjes së anomalive tjera, si dhe me rastin e ndrrimit të tubave, riparimit të defekteve, ndërtimit të pjesëve të reja të tubacionit.</li> </ul>
4	<b>Mirëmbajtja e rregulltës mekanizmit dhe automjeteve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prokurimi i eskavatorit rrotullues;</li> <li>• Prokurimi i automjetit kamion hale me vinç</li> <li>• Mirëmbajtja e të gjitha automjeteve në gjendje të rregullt teknike me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve operative.</li> </ul>

SHPK "Ujësjellësi dhe kanalizimi" në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale përpinqet për zhvillim të balancuar të gjitha bashkësive lokale, kur bëhet fjalë për furnizimin publik me ujë, si një ndër kushtet më të rëndësishme për rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve.

## 2.4. SEKTORI PËR PUNËT EKONOMIKO JURIDIKE

Një ndër detyrat më të rëndësishme të këtij sektori është evidentimi i saktë i përdoruesve të shërbimeve komunale, faturimi i shërbimeve sipas të gjitha kategorive të konsumatorëve (amvisëritë dhe personat juridik) dhe arkëtimi sa më efikas i llogarive. Zhvillimi cilësor dhe eficent i sistemit informativ është përbërës shumë i rëndësishëm i çdo procesit të punës sepse mundëson mbështetje sistemore dhe aplikative të gjitha njësive organizative të Shoqërisë. Me mbajtjen e evidences kontabiliste në bazë të rregullave të normuara dhe në pajtim me standartet relevante të kontabilitetit MRS, Ligjin mbi kontabilitet dhe auditim kontribohet pasqyrimi objektiv të veprimtarisë financiare dhe rezultateve të Shoqërisë, e me vetë këtë kontribohet për ruajtjen e likuiditetit.

Sektori për çështjet juridike përfshinë edhe punët administrative-juridike nga lëmia e punës së Shoqërisë, mbrojtjen e pronës dhe objekteve të Shoqërisë dhe sigurimin e mjeteve themelore dhe inventarit të domosdoshëm për veprimtarinë. Udhëheqja e rregullt e politikës së biznesit nënkuption kryerjen e veprimtarisë në pajtim me kornizën legislative që është e normuar për veprimtarinë që kryen kjo Shoqëri. Kualifikimet menaxhuese dhe profesionale të punësuarve, atmosfera pozitive e punës dhe siguria në punë janë elementet kyçë për organizimin adekuat të veprimtarisë dhe arritjes së rezultateve pozitive, e me vetë këtë ngritja e kapaciteteve kadrovike dhe avansimi i çështjeve nga fusha e punës janë qëllimet kryesore të këtij sektori. Në vitin 2023 theks i veçantë do të vihet në avansimin e çështjeve nga fusha e punës, përditësimin e evidencës amë, menaxhimin efikas me resurset njerëzore, ngritjen e kapaciteteve kadrovike, përmirësimin e kushteve të punës për të punësuarit.

Numri i të punësuarve në Shoqëri është i mjaftueshëm për kryerjen e papenguar dhe cilësore të veprimtarisë, ç'gjë e tregon edhe indikatori i kualitetit të shërbimeve. Gjithashtu, në nivel të kënaqshëm është edhe struktura kualifikuese dhe sipas moshës, e kjo më së miri dëshmohet me faktin se numri i të punësuarve të cilët kryejnë punët nga lëmia e veprimtarisë themelore përbën 60,87% të numrit total të punësuarve.

Prioritetet janë si vijon:

## 2.5. AKTIVITETET PRIORITARE TË SEKTORIT (Shërbimi për çështjet juridike) në vitin 2023

Tabela 7

Nr.r	QËLLIMI OPERATIV	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA
1	Avansimi i çështjeve nga fusha e punës	<ul style="list-style-type: none"><li>Përgatitja me kohë e akteve individuale për të punësuarit;</li><li>Zvogëlimi i kohës mesatare të nevojshme për përgatitjen e akteve;</li><li>Krijimi i masave për avansimin e organizimit të punës dhe kryerjes së punëve;</li><li>Procedimi me kohë sipas kërkesave të punësuarve;</li><li>Korresponda e vazhdueshme me Entin për punësim, Fondin e SPI, Administratën tatimore, Administratën e Kuadrove.</li></ul>

2	<b>Mbajtja efiçente dhe e përditësuar e evidencës amë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përditësimi i rregulltë i bazës së të dhënave;</li> <li>• Avansimi i sistemit informativ në kuptimin e përmirësimit të programit për evidencën kadrovike;</li> <li>• Përgatitja e dosjes personale elektronike të të punësuarit;</li> <li>• Përgatitja e planit vjetor të pushimeve vjetore dhe përcjellja e realizimit të tij;</li> <li>• Mbajtja e rregullt dhe e saktë e evidencës mbi orarin e punës të punësuarve;</li> <li>• Zvogëlimi i gabimeve të mundshme në mbajtjen e evidencës amë.</li> </ul>
3	<b>Puna efikase në lëminë e punëve administrativo-juridike në punën e Bordit të drejtorëve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimi i seancave të Bordit të drejtorëve;</li> <li>• Përgatitja e materialit për seancë dhe dorëzimi i tij me kohë;</li> <li>• Mbajtja e procesverbalit detajor nga seanca;</li> <li>• Përgatitja e Vendimeve dhe shënimëve zyrtare nga seancat.</li> </ul>

4	<b>Mbajtja adekuate dhe e përditësuar e evidencës të materialit regjistrues</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbajtja e evidencës në pajtim me Rregulloren e veprimtarisë në zyre dhe veprimtarinë arkivore;</li> <li>• Kryerjen e rregullt të punëve të përgjedhjes së materialit arkivor dhe ekskretimi i materialit të pavlefshëm regjistrues;</li> <li>• Trajnimi shtesë i të punësuarve në këtë pjesë të punëve.</li> </ul>
5	<b>Avansimi i menaxhimit me resurset njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve kadrorike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza detajore e nevojave për resurse njerëzore;</li> <li>• Përgatitja e hartës së kompetencave;</li> <li>• Përcjellja dhe vlerësimi i suksesit të të punësuarve;</li> <li>• Avansimi i atmosferës së punës;</li> <li>• Edukimi i të punësuarve me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve të veprimtarisë dhe përmirësimit të punës të punësuarve;</li> <li>• Investim në aftësimin dhe përmirësimin profesional të punësuarve.</li> </ul>
6	<b>Përmirësimi i kushteve të punësuarve nga pikëpamja e sigurisë dhe mbrojtjes në punë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Harmonizimi i rregullativës ekzistuese nënligjore me Ligjin mbi mbrojtjen dhe shëndetin në punë;</li> <li>• Kryerja e kontrolleve të rregulla mjekësore dhe sistematike;</li> <li>• Kontrollet periodike sistematike të punësuarve që punojnë në vendet me rrezik të shtuar;</li> <li>• Përgatitja e aktit mbi vlerësimin e rrezikut për të gjitha vendet e sistematizuara të punës.</li> </ul>

	<p><b>7 Shërbime efiçente të prokurimit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prokurim i rregulltë dhe i kontrolluar i pajisjeve, inventarit, materialit të imtë dhe të madh;</li> <li>• Përcjellja e vazhdueshme e realizimit të kontratave të lidhura;</li> <li>• Përcjellja e vazhdueshme dhe zbatimi i dispozitave nga lëmia e prokurimeve publike;</li> <li>• Ofrimi i mbështetjes profesionale dhe teknike me rastin e përpilimit të Planit të prokurimeve publike dhe pjesëmarrja aktive në përgatitjen dhe zbatimin e tij;</li> <li>• Përzgjedhja racionale e ofertuesit më të volitshëm në pajtim me ligjin;</li> <li>• Grumbullimi dhe analiza e informacioneve të karakterit intern dhe ekstern me qëllim të avansimit të veprimtarisë;</li> <li>• Hulumtimi permanent i tregut të prokurimeve me qëllim të pasqyrës sa më reale mbi vlerësimet e vlerave të prokurimeve të planifikuara;</li> <li>• Avansimi i komunikimit të brendshëm me deponë me qëllim të furnizimit me kohë dhe të rregulltë me mall dhe ruajtja e tij;</li> <li>• Avansimi i sistemit informativ në pjesën që ka të bëjë me përcjelljen e vëllimit të mallrave, shërbimeve dhe punimeve të klasifikuara sipas Planit të prokurimeve publike.</li> </ul>
<p><b>8 Përditësimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve</b></p>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Inicimi i aksionit për përditësimin e bazës së të dhënave të konsumatorëve me sistemin e „regjistrimit“ përmes rievidentimit të terrenit;</li> <li>• Përditësimi konstant i bazës së të dhënave mbi konsumatorët në bazë të kontrolleve të kryera dhe kërkesave të parashtruara për ankesa;</li> <li>• Nënshkrimi i Kontratës me konsumatorët;</li> <li>• Bashkëpunimi i vazhdueshëm me vetëqeverisjen lokale dhe institucionet kompetente me qëllim të përfitimit të numrit sa më të madh të informatave të dobishme.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza detajore e arsyeve të parashtrimit të ankesave dhe eliminimi i tyre;</li> <li>• Zgjidhja më e shpejtë dhe e thjeshtë e kërkesave të konsumatorëve;</li> <li>• Informimi më i mirë i konsumatorëve mbi mundësinë e paraqitjes së konsumimit përmes web portalit;</li> <li>• Njoftimi i konsumatorëve me përparësitë të cilat i ofron shërbimi e-llogaria (dorëzimi i llogarisë përmes mail-it);</li> <li>• Hapja e Call center për konsumatorët ku do të fitojnë të gjitha informacionet e shërbimit;</li> <li>• Informimi i konsumatorëve mbi të gjitha mundësitetë dhe shërbimet të cilat i kanë në dispozicion.</li> </ul>
9	Zvogëlimi i numrit të ankesave dhe përmirësimi i komunikimit me konsumatorët	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lokalizimi dhe zbulimi i konsumatorëve të cilët janë të lidhur ilegalisht në rrjet;</li> <li>• Kontrolli i rregulltë i konsumatorëve të cilëve përkohësisht u është ndaluar ofrimi i shërbimeve;</li> <li>• Sanksionimi i rreptë i këtyre konsumatorëve përmes shkëputjes nga rrjeti dhe parashtrimit të kallëzimeve penale;</li> <li>• Evidentimi detajor i kësaj kategorie konsumatorësh me të gjitha të dhënat e domosdoshme;</li> <li>• Kontrolli i objekteve të dimensioneve të mëdha tek të cilat regjistrohet konsumim i vogël me qëllim të parandalimit të konsumimit ilegal.</li> </ul>
10	Zvogëlimi i humbjeve komerciale dhe teknike	

Me realizimin e qëllimeve të përmendura operative do të kontribohet në rritjen e realizimit të faturuar përmes leximit të saktë dhe efikas të instrumenteve matëse, përmirësimit dhe modernizimit të sistemit të arkëtimit, rritjes së arkëtimit të llogarive dhe komunikimit më të mire me konsumatorët.

### **III VEPREMTARIA THEMELORE E SHOQËRISË**

#### **3.1 SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË**

Furnizimi me ujë paraqet nevojë primare të qytetarëve. Aktualisht në sistemin e furnizimit të organizuar me ujë janë të kyçur 90% e banorëve të Komunës së Tuzit. Pjesa më e madhe e banorëve që nuk ka sistem të organizuar të furnizimit me ujë gjendet në trevën rurale.

#### **3.2. RRJETI I UJËSJELLËSIT**

Një ndër parakushtet themelore të furnizimit të rregulltë me ujë është mirëmbajtja adekuate e rrjetit të ujësjellësit. Rrjeti i ujësjellësit është i ndarë në rrjetin primar, që përfshin tubacionet transportuese shpërndarëse, rrjetin sekondar nga i cili furnizohen konsumatorët dhe rrjetin terciar që në të shumtën e rasteve paraqet pjesën lidhëse të tubacionit prej rrjetit sekondar deri në vendin matës të konsumatorit.

Gjatësinë e përafërt të rrjetit primar dhe rrjetit sekondar, përmes të cilit shpërndahet uji deri te konsumatori, nuk e kemi të njohur, sepse SHPK „Ujësjellësi dhe kanalizimi“ Podgorica edhe përkundër insistimit tonë të vazhdueshëm refuzon të na japë kadastrën e instalimeve (të rrjetit të ujësjellësit).

#### **3.3. STACIONET E POMPIMIT**

Komuna e Tuzit me vendbanimet në periferi, me ujë të pijshëm furnizon prej katër burimeve, të kapacitetit total të instaluar prej rreth 330 L/s. dhe atë:

SP „Tuz“ 12 l/s

SP „Milesh“ 78 l/s (43l/s, 20 l/s, 15 l/s)

SP „Vuksanlekaj“ 130 l/s (45 l/s, 85 l/s)

SP „Dinoshë“ dy 110 l/s

Ky sistem disponon me rezervuaret si vijon:

- Rezervuarin „Vuksanlekaj“, të ndërtuar dhe të lëshuar në funksion në vitin 2010, me kapacitet  $800\text{m}^3$ ,
  - Rezervuarin „Milesh“, me kapacitet  $200\text{ m}^3$ ,
  - Rezervuarin „Mali i Lekajve“, të ndërtuar në vitin 2012, me kapacitet  $800\text{m}^3$  dhe
  - Rezervuarin „Dinoshë“ me kapacitet  $400\text{m}^3$ .
- Kapaciteti total i rezervuareve është  $2200\text{ m}^3$ .

Këtu është e nevojshme që veçanërisht të theksojmë se është arritur marrëveshja mes dy Shoqërive që

punët e mirëmbajtjes të stacioneve të pompimit dhe rezervuareve si dhe pagesën e energjisë elektrike për shtypjen e ujit nga rezervuaret për vitin 2022 e merr përsipër SHPK „Ujësjellësi dhe kanalizimi“ Podgorica.

### 3.4. CILËSIA E UJIT

Analizën kimike dhe bakteriologjike të ujit për nevojat e SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz, e kryen SHPK „Ujësjellësi dhe kanalizimi“ Podgorica në bazë të marrëveshjes së nënshtkuar në fillim të vitit 2022. Të gjitha analizat dhe raportet të cilat na janë dorëzuar tregojnë që qytetarët konsumojnë ujë të shëndetshëm dhe të rregulltë nga ana kimike dhe bakteriologjike. Në periudhën e planifikuar e me qëllim të shpërndarjes të ujit të pijshëm të sigurtë e të shëndetshëm në vitin 2023, do të përcjellim cilësinë e ujit dhe atë përmes dorëzimit të rregulltë të raporteve të cilat i kryen Instituti për shëndetin publik, Podgorica. Pra, kemi për qëllim, furnizimin publik me ujë, të vazhdueshëm, të sigurtë dhe cilësor, duke ruajtur ambientin dhe shëndetin e njerëzve, e do ta realizojmë përmes:

- Marrjes dhe testimit të rregulltë të ujit të vëllimit themelor tri herë në muaj.
- Testimit periodik (analiza B) të cilësisë së ujit 12 mostra 2 herë në vit.
- Testimit periodik (analiza C) të cilësisë së ujit 6 mostra në vit.

Poashtu, çdo ditë do të kryhet kontrolli i përqendrimit të klorit rezidual në burimet dhe disa vende rrjedhëse në vendbanime.

Pos kësaj, do të kryhet testimi i jashtëzakonshëm i ujit në rast të reshjeve të dendura dhe paraqitjes së anomalive tjera, si dhe me rastin e ndrrimit të tubacionit, riparimit të defekteve, ndërtimit të pjesëve të reja të tubacionit.

### 3.5. POLITIKA E ÇMIMEVE

SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz, i arkëton shërbimet e veta sipas çmimores të miratuar nga ana e Agjencionit rregullues për energetikë dhe rregullimit të veprimtarisë komunale me vendimin numër 22/245-15 të dt. 18.04.2022

Në ditën e përpilimit të Programit të punës çmimorja e SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz, nuk është ndryshuar, as plotësuar, por planifikohen ndryshime dhe plotësimë të çmimores, ashtu që pritet që në vitin 2023 SHPK “Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi” Tuz shërbimet e veta do t'i arkëtojë sipas çmimeve që do të janë të përmbajtura në ndryshimet dhe plotësimet e çmimores. Ndryshimi i çmimeve është i kushtëzuar me harmonizimin e çmimeve me gjendjen reale në treg. Me Nenin 54 paragrafi 1 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale është normuar që çmimin për kryerjen e veprimtarisë komunale e përcakton kryerësi i veprimtarisë komunale. Kryerësi i veprimtarisë komunale përcakton çmimin për kryerjen e atyre veprimtarive me pëlgim paraprak të Agjencionit rregullues për energetikë, përkatësisht njësisë të vetëqeverisjes locale (Neni 54 paragrafi 1 dhe Neni 55 paragrafi 1 dhe 2). Mënyra e përcaktimit të çmimeve dhe politika e dhëties së pëlgimit në propozimin e çmimeve është përcaktuar me Metodologjinë përcaktimin e çmimit për kryerjen e veprimtarive të rregulluara komunale (“Gz. zyrtare e MZ”, nr. 56/20, 33/21 i 51/21).

Çmimi sipas metodologjisë përbëhet prej pjesës fikse dhe pjesës variabile.

Pjesa fikse mundëson kthimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes vijuese të infrastrukturës komunale dhe pajisjeve përcjellëse, shpenzimet e materialit dhe mundëson që kryerësi i veprimtarive komunale gjatë gjithë vitit të ketë të ardhura uniforme, në mënyrë që të mund ta mirëmbajë sistemin shpërndarës në mënyrë adekuate. Pjesa variabile e çmimit vendoset në sasinë e ujit të dërguar konsumatorëve dhe përcaktohet për çdo  $m^3$  që është 0,4356€ prej dt. 01.01.2022. Çmimi i njëjtë është planifikuar edhe për vitin 2023 në bazë të vendimit të Agjencionit rregullues për energetikë dhe rregullimit të veprimtarisë komunale.

### 3.6. MENAXHIMI I RISQEVE

Menaxhimi i risqeve është obligim ligjor dhe element i pashmangshëm i menaxhimit të mirë me kompani. Menaxhimi përkatës me risqet ka rëndësi të madhe për vetë kompaninë publike dhe për aftësinë e kryerjes cilësore të obligimeve. Menaxhimi i risqeve është pjesa qendrore e administrimit strategjik. Strategjia paraqet kornizë gjithëpërfshirëse për përkrahje personave përgjegjës për zbatimin e planit strategjik. Në këtë strategji si risk konsiderohet çdo ngjarje që mund të ndodh dhe të ndikojë negativisht në arritjen e qëllimeve strategjike dhe operative. Mundësitet e humbura poashtu konsiderohen risk. Menaxhimi i risqeve është instrument që u ndihmon udhëheqësve të parashohin ngjarjet negative dhe të reagojnë në to. Menaxhimi i risqeve është çelësi për suksesin e kompanisë në realizimin e qëllimeve të veprimtarisë dhe mbrojtjes së interesave.

Qëllimi i kompanisë është të dallojë riskun, të njëtin ta masë dhe të ndërmarrë masat përkatëse për evitim ose zbutjen e pasojave të tij.

Me risk nënkuftohet mundësia e paraqitjes së ngjarjes që mund të ndikojë negativisht në realizimin e qëllimeve të Shoqërisë. Proceset e punës përbëhen prej një sere aktivitetesh, të cilat janë të ekspozuara llojeve të caktuara të riskut.

Më të rëndësishmit janë të pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela 8

1	Prodhimi i ujit të pastër	Kapacitetet e pamjaftueshme të puseve
		Cilësia joadekuate e ujit
2	Shpërndarja e ujit të pastër	Rritja e humbjeve fizike si pasojë e tubacionit të vjetëruar
		Aksidentet në rrjetin e ujësjellësit si pasojë e vjetërsisë
3	Kullimi i ujërave të zeza	Përmbytjet si pasojë e të reshurave atmosferike
		Aksidentet si pasojë e mosmirëmbajtjes
4	Investimet dhe zhvillimi	Mospërputhja e kërkesave të donatorëve me dokumentacionin ekzistues projektues teknik

### 3.7. VEPRIMTARIA SHTESË E SHOQËRISË

Në Shoqëri kryhen edhe **veprimtaritë shtesë**, me qëllim të shfrytëzimit më të plotë të

kapaciteteve dhe atë:

ndërtimi i objekteve hidroteknike të rrjetit primar dhe sekondar të ujësjellësit dhe kanalizimit, përpilimi i dokumentacionit projektues-teknik nga lëmia e hidroteknikës, kryerja e lidhjeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, -riparimi dhe kalibrimi i ujëmatësve. Përshkrimi detajor është dhënë në tabelën vijuese.

**Tabela 9** Plani i aktiviteteve për ofrimin e shërbimeve shtesë në vitin 2023

Nr.r.	Përshkrimi	Numri i pritur i rasteve
1.	Pëlqimi në dokumentacionin projektues	20
2.	Kadastra e instalimeve	2
3.	Lidhjet në ujësjellës	120
4.	Evidenca e konsumatorëve ilegal	25
5.	Kushtet teknike të lidhjes në ujësjellës dhe kanalizim	80
6.	Evidenca e konsumatorëve ilegal	20
	Kushtet teknike të lidhjes në ujësjellës dhe kanalizim	15
<b>GJITHSEJT</b>		<b>284</b>

### **3.8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË MIRËMBAJTJEN E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT NË VITIN 2023**

Aktivitetet që kanë prioritet absolut në pajtim me misionin e Kompanisë dhe obligimin e kryerjes të veprimtarive komunale kanë të bëjnë me dërgimin e sasive të mjaftueshme të ujit të rregullt nga ana higjenike të gjithë përdoruesve të sistemit të ujësjellësit dhe kullimin e ujërave atmosferike. Në pajtim me këtë, është e nevojshme të gjitha pjesët e këtij sistemi të mbahen në gjendje të rregullt pune në vazhdimësi dhe në funksion të plotë që është e mundur të realizohet me sigurimin me kohë të sasisë së nevojshme të materialeve kualitative dhe rezervave të tyre, shërbimeve nga ana e disa furnizuesve, përgatitja dhe pajisja e të punësuarve, mobiliteti dhe organizimi i mirë i punës.

Aktivitetet e planifikuara që do të zbatohen në vitin 2023, kanë të bëjnë me mirëmbajtjen vijuese e rrjetit të ujësjellësit dhe objekteve të rrjetit.

Pasqyra detajore e aktiviteteve të planifikuara është dhënë në tabelën vijuese.

**Tabela 10 Aktivitetet e planifikuara në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit**

Nr.r.	Pozita	Përshkrimi i pozitës	Nj. mat.	Sasia	Orët e punës
1.1.	Mirëmbajtja vijuese	Riparimi i defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe objektet e rrjetit (tubat e ujësjellësit, pusetat, lidhjet dhe stacionet e pompimit), sipas paraqitjeve	Numri interv.	280	850
1.2.		Punimi i tubacioneve të reja me instalim të nyje	m nyje	2.000	4.000
1.3.		Rekonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit me rilidhje të konsumatorëve	m	600	400
1.4.		Pastrimi manual i pusetave në rrjetin primar dhe sekondar të ujësjellësit me bartje të materialit në landfill	copë	390	1300
1.5.		Mbyllja dhe mbrojtja e tubacionit dhe hidrantave me kërkesë të personave të tretë	copë	150	375
1.6.		Vendosja e kapakëve në pusetat e ujësjellësit si pasojë e thyerjes ose tjetërsimit	copë	100	400
1.7.		Mirëmbajtja e armaturave të ujësjellësit në rubinetat dhe shadërvanat publik	copë	100	300
1.8.		Inspektimi dhe kontrolli i rrjetit të ujësjellësit	numri interv.	100	2.400
1.9.		Shpëlarja e rrjetit të ujësjellësit	m	2.000	40

### **3.9. KOMPLETIMI I KADASTRËS SË INSTALIMEVE PËR RRJETIN E UJËSJELLËSIT TUZ**

Zbulimi dhe riparimi i humbjeve është punë afatgjate për të cilën nevojiten të krijohen parakushte të caktuara. Parakushti themelor është identifikimi dhe inçizimi i vendndodhjes së tubacioneve ekzistuese dhe evidentimi i tyre kadastral.

Shoqëria nuk posedon bazat kadastrale të rrjetit ekzistues, (edhe përkundër faktit që më shumë herë i jemi drejtuar SHPK "Ujësjellësi dhe kanalizimi" Podgorica) ashtu që duke e përmbyllur me ditën e përpilimit të këtij Plani dhe Programi të punës, Shoqëria planifikon të ndërmarrë aktivitetet vijuese:

- 1) Që me rastin e kryerjes së punëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, të sigurojë kushtet për inçizimin e situates përpilimin e dokumentacionit projektues në vitin 2023.

- 2) Shoqëria do të insistojë në dorëzimin dhe kompletimin e kadastrës së instalimeve të rrjetit të ujësjellësit të cilën e posedon SHPK "Ujësjellësi dhe kanalizimi" Podgorica.

### **3.10. SISTEMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK**

SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, në pajtim me kompetencat e veta kryen punët e mirëmbajtjes të sistemit të kanalizimit atmosferik dhe në pajtim me këtë kryen shpëlarjen e rregulltë, zhbllokimin e rubinetave publike dhe pusetave.

Kanalizimi atmosferik shërben për kullimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet, rrugët, trotuaret, oborret e objekteve banesore dhe objekteve tjera.

Pasi në Tuz nuk ekziston as kanalizimi fëkal, as ai atmosferik, konsiderojmë se ato dy sisteme duhet ndërtuar ndaras në të ardhmen në mënyrë që të mos vijmë në situatë të mbingarkesës që do të kishte për pasojë krijimin e zgjidhjeve të këqija nga aspekti i higjenës së vendbanimit.

### **3.11. AKTIVITETET PROGRAMORE NË BAZË TË KONTRATAVE TË PLANIFIKUARA ME VETËQEVERISJEN LOKALE**

Në pajtim me obligimet e definuara dhe aktivitetet që rrjedhin prej Vendimit mbi themelimin e shoqërisë, si dhe Vendimit mbi furnizimin publik me ujë SHPK „Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi“ Tuz, në vitin 2023 janë planifikuar aktivitetet e rradhës:

- Përpilimi i të gjitha raporteve të domosdoshme në pajtim me kërkesat e investitorëve, organeve kompetente të administratës shtetërore dhe lokale, në vitin 2023;
- Komunikimi i rregulltë me organizatat dhe institucionet, sigurimi i informacioneve relevante dhe dokumentacionit në pajtim me Kontratën financiare për implementimin e kontratës që reflektohen në ngritjen e nivelit dhe furnizimit me ujë në Komunë;
- Ofrimi i ndihmës profesionale në kryerjen e të gjitha obligimeve tjera, aktivitetet, vendimet, lejet etj. të cilat konsiderohen të domosdoshme për implementim të suksesshëm dhe me kohë të projektit / në vitin 2023;
- Kryerja e aktiviteteve tjera të cilat rrjedhin nga Kontrata e nënshkruar dhe zakonet e mira të afarizmit / aktivitet i vazhdueshëm në vitin 2023.

## **IV PLANI FINANCIAR**

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve, përkatësisht plani finansiar i veprimtarisë, është punuar në bazë të planit natyror të shpenzimit të ujit, çmimeve ekzistuese për  $m^3$  të ujit të shpenzuar, vlerësimi mbi rritje të lehtë të konsumatorëve, përkatësisht përdorues të rinjë të sistemit të ujësjellësit, numrit ekzistues të punësuarve në Shoqëri, vlerës aktuale të përllogaritjes të koeficientit

për përllogaritjen e pagave, planit të prokurimit të pjesëve të këmbimit dhe të materialit dhe planit për mirëmbajtjen vijuese të mjeteve. Burimet totale të financimit të SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz kapin shumën **640.000.00 €**.

Në pjesën më të madhe kjo Shoqëri veprimtarinë e vetë e financon nga mjetet vetanake, të realizuara me anë të shitjes të shërbimeve nga lëmia e veprimtarisë së vetë, e pjesërisht edhe me ndihmën, para së gjithash, të themeluesit dhe atë në aktivitetet investuese. Shpenzimi i ujit gjatë viti të kaluar dhe vlerësimi ynë mbi rritjen e lehtë të numrit të konsumatorëve e kanë përcaktuar shpenzimin e planifikuar të ujit në vitin 2023.

Për vitin 2023, në krahasim me vitin e kaluar, është planifikuar rritja totale e shpenzimit të ujit për 4,62%. Tek konsumatorët "kompanitë dhe institucionet" llogaritet vazhdimi i trendit të rritjes së konsumimit për vitin 2023 ku është planifikuar rritja e dërgimit të ujit këtyre konsumatorëve për 11,11%.

Rritja e planifikuar e dërgimit të ujit konsumatorëve "personat fizik" është mbi 4,348% dhe ato, kryesisht bazohen në rritjen e numrit të konsumatorëve dhe pasqyrimi më të hershëm të shpenzimit.

Në Planin e të ardhurave është kalkuluar me çmimet ekzistuese për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Por e përsërisim qëndrimin tonë të parashtruar më herët edhe në Raportin mbi punën e Shoqërisë për 6 dhe 9 muaj që niveli i çmimeve është bërë faktor kufizues për veprimtarinë e mëtejme të suksesshme të Shoqërisë dhe që mundëson veprimtarinë vetëm në nivel të reprodukimit të thjeshtë, pa mundësi të investimeve të mëdha në pajisjen teknike të Shoqërisë.

**PASQYRA ANALITIKE E PUNIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHOQËRISË NË VITIN 2023** Tabela 11

Nr.r.	Përshkrimi	Plani për vitin 2023
<b>TË ARDHURAT</b>		
1.	Të ardhurat nga buxheti i komunës për veprimtarinë e rregulltë	60,000.00
2.	Të ardhurat e rregulla të cilat i realizon kompania nga veprimtaria e vetë	564,000.00
	2.1.Të ardhurat nga uji i dërguar personave fizik	480,000.00
	2.2 Të ardhurat nga uji i dërguar personave juridik	20,000.00
	2.3.Të ardhurat nga lidhjet	38,000.00
	2.4.Të ardhurat nga lidhjet ilegale në rrjet	10,000.00
	2.5.Të ardhurat nga refundimet-pushimet mjekësore	5,000.00
	2.6.Të ardhurat nga të ardhurat financiare	1,000.00
	2.7.Shërbimet tjera(pëlqimet, pun.instaluese)	10,000.00
3.	Të ardhurat tjera	16,000.00
	3.1.Të ardhurat nga donacionet	5,000.00
	3.2.Të ardhurat tjera nga veprimtaria	6,000.00
	3.3.Të ardhurat nga viti i kaluar	5,000.00
	<b>TË ARDHURAT NGA VEPRIMTARIA E RREGULLTË(1+2+3)</b>	640,000.00
	<b>TË ARDHURAT TOTALE</b>	<b>640,000.00</b>

## PASQYRA ANALITIKE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHOQËRISË NË VITIN 2023

**Tabela 12**

<b>1.</b>	<b>Shpenzimet e mirëmbajtjes</b>	<b>109,200.00</b>
	1.1.Shpenzimet e materialit dhe pjesëve të këmbimit	61,000.00
	1.2.Shpenzimet e mirëmbajtjes të ujësjellësit dhe kanalizimit	13,000.00
	1.3.Shpenzimet e materialit për zyre	18,000.00
	1.4.Shpenzimet e materialit për mirëmbajtjen e higjienës	1,000.00
	1.5.Shpenzimet e materialit tjeter (inv. i imët, goma-auto,regji..)	2,000.00
	1.6.Shpenzimet e karburantit dhe energjisë	14,200.00
<b>2.</b>	<b>Pagat dhe kompensimet për të punësuarit</b>	<b>390,000.00</b>
	2.1.Shpenzimet e pagave neto për punë të rregulltë	292,090.00
	2.2.Shpenzimet e kontributeve në ngarkesë të punëdhënësit	16,810.00
	2.3.Shpenzimet e kontributeve në ngarkesë të të punësuarit	59,500.00
	2.4.Kompensimet tjera (mëditjet, ndihmat..)	2,000.00
	2.5.Shpenzimet e kompensimeve anëtarëve të Bordit të drejtoreve	6,300.00
	2.6 Shpenzimet për kontratat mbi veprën	12,000.00
	2.7.Shpenzimet për mbitatim në tatim	1,300.00
<b>3.</b>	<b>Shpenzimet e shërbimeve prodhuese</b>	<b>5,000.00</b>
	3.1.Shpenzimet e riparimit të pajisjeve	3,000.00
	3.2.Shpenzimet e shërbimeve të mbrojtjes në punë	500.00
	3.3.Shpenzimet e shërbimeve të mirëmbajtjes	1,500.00
<b>4.</b>	<b>Shpenzimet jomateriale</b>	<b>43,000.00</b>
	4.1.Shpenzimet e shërbimeve joprodhuese (noteriale, gjyqësore dhe të avokatisë)	2,000.00
	4.2.Shpenzimet e përfaqësimit(nevojat e ushqimit për të punësuarit)	4,000.00
	4.3.Shpenzimet e marrjes me qira të kamionit dhe eskavatorit	6,000.00
	4.4.Shpenzimet e transaksionit të pagesave	1,000.00
	4.5 Shërbimet gjeodezike	6,000.00
	4.6.Shërbimet komunikuese dhe shërbimet e internetit	4,000.00
	4.7. Shërbimet telefonike-rrjeti celular	5,000.00
	4.8.Shërbimet e printimit	2,000.00
	4.9.Shërbime konsulencë	6,000.00
	4.10.Shpenzimet tjera jomateriale (shërbime të përkthimit)	500.00
	4.11.Shërbime të mirëmbajtjes dhe mbështetjes të sistemit informativ	6,000.00
	4.12. Shpenzimet e shërbimeve komunale	500.00
<b>5.</b>	<b>Shpenzime tjera</b>	<b>87,800.00</b>

	<b>5.1.Donacione, sponzorizime, publicitet</b>	<b>3,500.00</b>
	5.2. Ndihma të njëherishme të punësuarve, individëve	2,000.00
	5.3.Shpenzimet e prokurimit të pajisjeve të sigurisë, automjetit, detektuesit të defekteve, pajisjeve kompjuterike, mobiljeve të zyres	18,300.00
	5.4. Kompensimet Agjencionit rregullues dhe Administratës së ujërave	36000.00
	5.5.Udhëtime zyrtare	2,000.00
	5.6. Shpenzime të qirasë	20,000.00
	5.7.Shpenzime të jashtëzakonshme	6,000.00
	<b>SHPENZIMET E VEPRIMTARISË SË RREGULLTË 1+2+3+4+5</b>	<b>635,000.00</b>

Të ardhurat e planikuara për vitin 2023 janë të projektuara në shumën totale 640,000€.

Burimet vetanake janë planifikuar me rritje prej 11,3% në nivel vjetor, me mbajtjen e çmimeve ekzistuese dhe rritjen e planifikuar të shpenzimit të shërbimeve komunale. Plani është që të ardhurat nga uji i dërguar konsumatorëve, që është parametri kryesor për realizimin e planit të ardhurave dhe të ardhurat nga shërbimet tjera do të janë të rritura për 11,3%.

Me planin natyror dhe financiar është paraparë rritja e shpërndarjes së ujit konsumatorëve final të shërbimeve për 4,602%. Rritja e planifikuar është bazuar në bazë të pritjeve reale sa i përket konsumimit të ujit, konsumatorëve të rinjë, evidentimit të konsumatorëve të paregjistruar dhe rritjes të konsumit nga ana e konsumatorëve ekzistues të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Nëse plani natyror shprehet financiarisht, me aplikimin e çmimeve ekzistuese, del që të ardhurat nga veprimtaria themelore do të janë 20.000.00€ më shumë.

Nëse Agjencioni rregullues për energetikë dhe veprimtaritë e rregulluara komunale deri në fund të vitit vijues, e jep pëllqimin paraprak në çmimet e reja të shërbimeve, të ardhurat e pritshme për vitin që vjen do të ishin më të mëdha për 20.000.00€ në krahasim me të ardhurat në bazë të çmimeve aktuale.

Analiza e të ardhurave të planikuara tregon se nga shitja e ujit shërbimi për banorët-amvisëritë do realizohet deri në 81,2%.

Përpos të ardhurave themelore, janë planifikuar edhe të ardhura tjera nga veprimtaria dhe ato janë paraparë në shumën 76.000€. Këto të ardhura i referohen të ardhurave në bazë të shërbimeve të instalimit të ujëmatësve të ri, arkëtimit të taksës për konsumatorët e rinjë të cilët janë të lidhur ilegalisht në rrjetin shpërndarës, në të ardhurat që priten prej institucioneve shtetërore në bazë të refundimit të pushimeve të lindjes dhe pushimeve tjera mjekësore.

Të gjitha të ardhurat e planikuara, janë dhënë në bazë të vlerësimit të realizimit nga viti vijues.

Në projekcionet planifikuese është i përfshirë edhe e ardhura financiare që ka të bëjë me përllogaritjen e interesit përvonesën në pagesën e llogarive për ujë (1.000€).

Poashtu, me plan financier janë paraparë edhe të ardhurat në bazë të arkëtimit të kërkespagesave të dyshimta dhe kontestuese nga viti 2022.

Kur janë në pyetje shpenzimet, me projeksione janë përfshirë shpenzimet materiale dhe shpenzimet e mirëmbajtjes, siç janë shpenzimet e mirëmbajtjes vijuese, shpenzimet e energjisë elektrike, karburantit, shërbimeve të transportit dhe shpenzimet tjera të karakterit material, që marrin pjesë me 17,19%.

Furnizimi i rregulltë me ujë, në pjesën më të madhe, varet prej mirëmbajtjes të rrjetit të ujësjellësit,

vjetërsia mesatare e të cilit është e madhe, në disa pjesë të komunës, ç'gjë ka si pasojë defekte të shpeshta dhe aksidente dhe kërkon investim të mjeteve të konsiderueshme në mirëmbajtjen vijuese të tubacioneve transportuese dhe rrjetit shpërndarës me të cilin menaxhon kjo Shoqëri.

Poashtu, faktor i rëndësishëm që ndikon në zvogëlimin e humbjeve në rrjetin shpërndarës është faturimi i saktë i ujit të shpenzuar që para së gjithash arrihet me mirëmbajtjen e ujëmatësve në gjendje të rregullt pune. Evident është numër i madh i ujëmatësve që duhen servisuar, përkatësisht ndrruar. Në bazë të analizës detajore, vlerësohet se për mirëmbajtjen vijuese të mjeteve infrastrukturore në vitin pasues është e nevojshme të dedikohen 74.000€, që në krahasim me përqindjen e realizimit në vitin 2022 është rritje prej 10%.

Mjetet për paga dhe të ardhurat tjera personale të punësuarve janë planifikuar në shumën 390.000.00€ dhe janë më të mëdha për 25% në krahasim me vitin 2022. Ky shpenzim bazohet në numrin ekzistues të punësuarve dhe korrigimin e pagave për vitin e ardhshëm dhe përbëjnë 61,41% të shpenzimeve totale.

Shpenzimet tjera jomateriale janë planifikuar në shumën 43.000.00€, gjegjësish 6,77% të shpenzimeve totale të planifikuara. Këto shpenzime kanë të bëjnë me mjetet e dedikuara për shpenzime të publicitetit, shpenzime për taksa, të transaksioneve të pagesave dhe shpenzimet tjera jomateriale të cilat paraqiten gjatë vitit.

Shpenzimet tjera përbëjnë 13,83% të shpenzimeve totale, duhet përmendur se në nivel vjetor dedikohen Agjencionit rregullues për energetikë dhe për veprimtaritë e rregulluara komunale. Vendimi mbi shumën e kompensimit bazohet në Nenin 50 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale. Mjetet e planifikuara për këto destinime në vitin 2023 janë 21500euro, derisa obligimet ndaj Administratës së ujërave për vitin 2022 janë 14 500 euro, dhe janë të përmbajtur në shpenzimet tjera, si shpenzimet e qirasë, sigurimit të pajisjeve, sigurimit, ndihmës së njëherëshme individëve, donacionet dhe publicitetit.

Nga sa është shënuar rrjedh përfundimi se qëllimi kryesor i Shoqërisë është veprimitaria me bilanc pozitiv, që do të thotë se me të ardhurat e realizuara mbulohen të gjitha shpenzimet e përllogaritura

Tabela 13 Shprehje përbledhëse

PLANI FINANCIAR	SHUMA
Totali i të ardhurave të planifikuara në vitin 2023	640,000.00
Totali i shpenzimeve të planifikuara në vitin 2023	635,000.00
Fitimi	5,000.00

## V PLANI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Në kuptimin e definimit dhe planifikimit të procedurave të prokurimit publik për nevojat e shoqërisë për vitin e ardhshëm, mund të dallohen qartë dy pjesë përbërëse të veçanta: operative dhe zhvillimore. Pjesën përbërëse operative e përbëjnë të gjitha ato procedura realizimi i të cilave mundëson funksionimin normal të kompanisë gjatë vitit afarist edhe tek të cilët është bërë praktikë sigurimi i furnizuesit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve përmes procedurave të tenderit. Nga ana tjetër, Planin e prokurimeve publike e përbën edhe pjesa zhvillimore e kompanisë, që është e bazuar në drejtimet strategjike të veprimit në kushtet e zhvillimit të veprimitarisë themelore dhe

veprimitarive sekondare. Pjesa zhvillimore e Planit të prokurimeve publike kërkon planifikim më të kujdesshëm dhe shpesh mund të pësoj ndryshime në varësi prej shumë faktorësh, siç janë kornizat variabile kohore të zbatimit, realizimi i parakushteve të caktuara të paparashikuara nga të cilat varet kryerja e projektit, parametrat e ndryshueshme financiare, ndryshimi i legjisacionit etj. Për këtë arsyë në Planin e prokurimeve publike për vitin 2023 janë propozuar vetëm procedurat e prokurimit përfdefinimin e parakushteve fillostarte për inicimin e projekteve zhvillimore dhe mirëmbajtjes (studimet e fizibilitetit, punimi i elaboratit mbi vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor, studimet e Planit të prokurimeve do të definohet në pajtim me dinamikën e realizimit. Aspekti tjetër karakteristik në planifikimin e procedurave të prokurimit publik për vitin 2023, prokurimeve të thjeshta, gjegjësisht prokurimeve vlera e vlerësuar e të cilave, për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve është më e vogël se 6.000 euro. Deri tani këto procedura janë realizuar me shopping metodën, gjegjësisht me lidhjen e marrëveshjes së drejtpërdrejtë. Të gjitha prokurimet publike të planifikuara në vitin 2023, si deri tani do të zbatohen në pajtim me zgjidhjet ligjore dhe atë: Ligjin („Gazeta zyrtare e MZ“, nr. 74/19) dhe Rregullores mbi prokurimet e thjeshta mbi prokurimet publike („Gz.zyrtare e MZ“, nr. 61/20, 65/20, 71/20, 74/20, 102/20 i 51/21).

## 5.1 Mjetet e planifikuara financiare për sigurimin e të mirave, punimeve dhe shërbimeve

MALLRAT		PROKURIMET PUBLIKE	Tabela 14
Num ren.	LËNDA	VLERA VLERËSUAR	E
1.	Mobilje zyre	2,800.00	
2.	Kompjuter dhe pajisje kompjuterike	4,000.00	
3.	Material i zorrëve	15,500.00	
4.	Material ndërtimor	5,000.00	
5.	Material hidraulik (pajisje hidraulike, armatura hidraulike dhe material lidhës, material i imët për mirëmbajtjen e ujësjellësit, material i galvanizuar)	16,000.00	
6.	Vegla dhe inventar i imët	2,000.00	
7.	Ujëmatësit	16,000.00	
8.	Kapakët e kanaleve dhe kapakët e pusetave	1,000.00	
9.	Karburante dhe lubrifikante	12,000.00	
10.	Material për zyre	18,000.00	
11.	HTZ pajisje (pajisje mbrojtëse) në punë	3,000.00	
12.	Përfaqësimi dhe shpenzimet e bufesë	4,000.00	
13.	Mjetet për mirëmbajtjen e lokaleve	1,500.00	
14.	Sigurimi i materialit për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjenës	1,000.00	

15.	Automjeti	6,000.00
16	Zbuluesi i defekteve	4,000.00
17.	Asfalti	4,500.00
	<b>GJITHSEJT</b>	<b>116,300.00</b>

**GJITHSEJT MALLRA .....**.....116.300.00 €

#### SHËRBIME

Tabela 15

Num rend.	LËNDA	VLE RA VLERESUAR
1.	Shërbimet e mirëmbajtjes dhe mbështetjes të sistemit informativ	6,000.00
2.	Shërbimet e komunikimit dhe shërbimet e internetit	4,000.00
3.	Shërbimet telefonike (rrjeti celular)	5,000.00
4.	Shërbimet e eskavatorit, shërbimet teknike, shërbimet e lidhura me ndërtimtarit	6,000.00
5.	Shërbimet e sigurisë në punë	500.00
6.	Shpenzimet e shërbimit të printimit	2,000.00
7.	Mirëmbajtja vijuese e automjeteve	3,000.00
8.	Shërbimet e sigurimit	1,500.00
9.	Shërbimet e radios dhe televizionit (publikimi i shkresave të ndryshme, konkurseve publike dhe ngjashëm)	1,000.00
10.	Shërbime konsulencë	6,000.00
11.	Shërbime gjeodezie (Elaborat ekspropriimi, nxjerra e një fotografie e gjendjes së përfshuar)	6,000.00
12.	Kalibrimi i ujëmatësve	1,000.00
13.	Shërbimet tjera	6,000.00
	<b>GJITHSEJT</b>	<b>48,000.00</b>

**GJITHSEJT SHËRBIME.....**.....48.000.00 €

Tabela 16 Punimet

Num. rend.	PUNIMET	Vlera e vlerësuar
1	Kryerja e punimeve në rrjetin sekondar	6,000.00
2	Punime në rrjet	6,000.00
	<b>GJITHSEJT</b>	<b>12,000.00</b>

**PUNIMET GJITHSEJT.....**.....12.000.00€

**GJITHSEJT =Malli+ Shërbimet+Punimet=.....176.300.00€**

## **5.2. POLITIKA E PAGAVE DHE PUNËSIMEVE**

Plani i pagave, kompensimeve të pagave dhe shpenzimeve tjera personale është bërë në bazë të udhëzimeve përpilimin e programit vjetor të punës për vitin 2023, përkatësisht programit të afarizmit për vitin 2022 dhe formave tjera të organizimit të cilat kryejnë veprimitari të interesit të përgjithshëm.

Pikënisjen me rastin e planifikimit të masës së mjeteve për pagat në vitin 2023, e përbëjnë pagat individuale, si dhe numri i planifikuar total i të punësuarve në vitin 2022 .

Në vitin 2022 është bërë harmonizimi i pagave më të ulëta me ngritjen e çmimit minimal të punës në pajtim me Ligjin mbi pagat në sektorin publik.

Poashtu në vitin 2022 është lidhur edhe Kontrata kolektive me të punësuarit e SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz, ashtu që postulatet kryesore të Kontratës kolektive janë zbatuar në planifikimin e shumës së mjeteve për paga dhe kompensim të pagave në kompani në vitin afarist 2023. Mjetet e planifikuara për të gjitha kompensimet tjera të pagave të punësuarve janë shtuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me udhëzimet përpilimin e Programit të punës për vitin 2023.

## **5.3 PLANI I RAPORTIMIT MBI PUNËN DHE VEPRIMTARINË E SHOQËRISË**

Raportimi mbi punën dhe veprimtarinë e SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz do të jetë në pajtim me rregullativën ligjore nga kjo lëmi, e me të cilën janë përcaktuar dhe rregulluar obligimet, mënyra dhe periudha e parashtrimit të raportit. Shoqëria do të respektojë edhe metodologjinë e normuar nga ana e Themeluesit, e në lidhje me raportimin e Kompanive publike dhe institucioneve.

Sipas standardeve kontabiliste ndërkombëtare në fuqi, si dhe Ligjit mbi kontabilitetin dhe auditimin në Mal të Zi është paraparë përpilimi i raporteve financiare për periudhën prej 3, 6, 9 muajsh dhe raportet vjetore të Shoqërisë.

## **5.4. PËRFUNDIM**

Gjendja aktuale ekonomike, stagnimi ekonomik, falimentimi i personave juridik, zvogëlimi i fuqisë blerëse, si dhe çmimi i ulët i shërbimeve, kanë ndikim negativ në veprimtarinë e Shoqërisë. Megjithatë, edhe në këto kushte Shoqëria me ndihmën e Themeluesit në periudhën vijuese do të punojë në avansimin e sistemit të furnizimit me ujë në mënyrë që të sigurojë dërgimin e vazhdueshëm, të sigurtë dhe cilësor të ujtit të gjithë konsumatorëve, me ruajtjen e përhershme të

shëndetit të konsumatorëve dhe ruajtjen e mjedisit jetësor.

Me këtë program të punës janë përbledhur problemet dhe mundësitë e zhvillimit të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit nga aspekti teknologjik, organizativ dhe ekonomik. Me plotësimin e qëllimeve të përmendura dhe aktiviteteve të planifikuara, me punën eficiente të gjitha njësive organizative, Shoqëria do të plotësojë qëllimin përfundimtar, e ai është vazhdimi i veprimtarisë së vetëqendrueshme.

Me qëllimet e definuara operative janë definuar prioritetet, masat dhe aktivitetet për realizimin e qëllimeve strategjike siç janë: rritja e të ardhurave, optimizimi i shpenzimeve, infrastruktura bashkëkohore komunale, organizimi bashkëkohor i biznesit, organizimi i avansuar teknologjik dhe IT. Përgjegjësia e Shoqërisë, të gjithë të punësuarve, por edhe e vetë qytetarëve është që në mënyrë të përgjegjshme të sillen ndaj resurseve natyrore, mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve. Shoqëria kësaj kërkesë do t'i përgjigjet përmes shpërndarjes ujit të rregullt nga ana higienike dhe me kullimin eficent të ujërave të zeza, si dhe përmes aplikimit të sistemeve të integruara të menaxhimit me proceset e definuara me standartet ndërkombëtare.

Metodë shumë e rëndësishme e veprimtarisë „SWOT analiza“ është bazë për përpilimin e programit të punës dhe me atë janë të definuara fuqitë, dobësitë, kërcënimet dhe mundësitë. Menaxhmenti me organizimin efikas të veprimtarisë do të shfrytëzojë fuqitë e dalluara për ndërtimin e kahjes së re të zhvillimit, derisa mangësitë e dalluara do t'i shndrrojë në forcë, gjegjësish me zhvillim të shpejtuar do të zvogëlojë ose tërësisht do t'i eliminojë ndikimet e tyre negative.

SHPK "Vodovod i kanalizacija/Ujësjellësi dhe kanalizimi" Tuz do të vazhdojë me mirëmbajtjen e financave stabile dhe trendin pozitiv të veprimtarisë të definuar me strategjinë përmes racionalizimit të shpenzimeve, rritjes së produktivitetit dhe vendimet adekuate organizative. Pjesë përbërëse e politikës së shoqërisë do të jetë kënaqësia e përdoruesve të shërbimeve, e kjo është e mundur të arrihet vetëm atëherë kur marrëdhënia përgjegjëse ndaj ofrimit të shërbimeve cilësore dhe avansimi i tyre i përhershëm do të jenë prioritet në punë.